Fletë udhëzuese mbajtja e zogjve

Jeta mesatare: Papagalli i valësuar dhe kanarinat deri 15 vite, agapornidët (kokëdrëndafilli) deri 20 vite, papagajtë deri 80 vite.

Shpenzimet

Kafsha	60-250 CHF	Varësisht nga lloji, papagajtë shumë më shtrenjtë
Shpenzime fillestare	1000-5000 CHF	Kafaz për zogjtë, degëzime për ngjitje, enë për ushqim dhe për ujë, banjë rëre, pajisje tjera
Shpenzimet vjetore	afër 500 CHF	Ushqim, shpenzimet për veterinerin, qëndrim në pension të shpezëve gjatë pushimeve ose përkujdesje në shtëpi
Të tjera	Shpenzimet e jashtëzakonshme të veterinerit mund ta kalojnë shumë çmimin e blerjes së shpendit.	

Zogjtë duhet të kenë mundësi të fluturojnë

Mbajtësit e ardhshëm të zogjve duhet të informohen hollësisht tek specialistët dhe me anë të literaturës së lëmisë para se të marrin vendim për mbajtjen e zogjve/shpezëve si kafshë shtëpiake. Kafazet e zakonshëm për zogj janë shumë të vogla dhe të papërshtatshëm për kafshë, ngase zogjtë nuk mund të flurojnë aty, por vetëm të kërcejnë poshtë e lartë dhe kështu tkurret muskulatura dhe çrregullohet sjellja e tyre. Kafazet me një sipërfaqe me të vogël se 2400 cm^2 (p.sh. 40 x 60 cm) janë të ndaluar për mbajtjen e shpezëve. Sipërfaqja minimale ligjërisht e paraparë përshkruhet si në vijim: Papagalli i valësuar dhe kanarinat: Së paku 2400 cm^2 sipërfaqe tokësore dhe 50 cm lartësi, papagalli nimfë dhe roselat: ½ m^2 dhe 60 cm lartësi, papagajtë më të mëdhenj (papagajtë gri, amazonat): 7000 cm^2 dhe 1.2 m lartësi, papagajtë ara dhe kakadu: 10 m^2 dhe 3 m lartësi. Mbajtja e zogjve në sipërfaqen minimale nuk do të thotë edhe mbajtje konform llojit përkatës të kafshës, ngase ata nuk mund të fluturojnë si duhet. Kush i lejon zogjve çdo ditë vetëm një orë fluturim të lirë, kështu që ata duhet ti kalojnë edhe 23 orë në kafaz, nuk i mban zogjtë e tij konform mbajtjes e duhur për llojin përkatës. Mbajtja në kafaz me një sipërfaqe prej disa metra katror është ideale ose mbajtja në një dhomë për zogj, me një pjesë të jashtme në hapësirë, edhe për zogjtë e vegjël, gjë e cila nuk e bën edhe të lirë mbajtjen e përshtatshme të shpesëve. Masat minimale të një kafaz janë 2 x 0.8 x 1,8 m për 6 kanarinë, i valësuar ose 2 papagaj nimfë. Llojet e vogla të papagajve kanë nevojë, për çdo rast, për një dhomë zogjsh me kafaz kopshti, papagajtë e mëdhenj kafaze të mëdha mbi 100 m^2, që në përgjithësi të fluturojnë. **Zogjtë nuk janë dekor për dhomë të ditës, dhe gjithashtu as lodra fëmijësh.**

Zogjtë janë social

Zogjtë nuk bën mbahen asnjëherë vetëm. Legjislacioni zviceran për mbrojtjen e kafshëve ndalon mbajtjen e zogjve të vetmuar, ngase ata stërkeqen në një jetë të pashpresë, të mërzitshme dhe të vetmuar. As pasqyra as zogjtë e plastikës as njeriu nuk janë zëvendësim, për një zog të llojit të njëjtë. Zogjtë jetojnë në shumicën e rasteve në çifte, të cilët mund të bashkohen në një luzmë (tufë/grup) të madh. Çiftet lidhen pjesërisht për krejt jetën dhe mbajnë një lidhje intensive. Pra, mbajtja e zogjve duhet të mundëson kontakte sociale të pakufizuar me zogjtë e llojit të njëjtë, në një grup të përbërë natyrshëm. Meshkujt e kanarinave nuk

duhet të mbahen vetëm, ata këndojnë po aq mirë dhe shpesh, nëse jetojnë bashkë me një femër – kënga shërben për ta ndjell femrën, për ta forcuar lidhjen dhe për të mbrojt territorin. Të folurit e papagajve të valësuar, të cilët mbahen vetëm, nuk paraqet asgjë tjetër veç një të metë.

Origjina e zogjve

Zgjidhni vetëm zogj të barrësimit/kultivimit zviceran dhe të mbajtjes së përshtatshme sipas llojit përkatës. Më së miri përshtaten ato lloje, të cilat j prej një kohe të gjatë janë kultivuar në robëri dhe për të cilët ka më shumë njohuri, pra kanarinat, papagalli valësues, çafkëbardhat e vogla japoneze dhe trishtilat tjerë shkëlqyes si trishtili zebër dhe lloje të ndryshme të agaponidëve. Për shumë lloje të papagajve është e nevojshme një miratim për mbajtje nga Enti kantonal i Veterinarisë. Zogjtë vendas nuk bën të kapen dhe të mbahen, përveç me miratim zyrtar.

Ku të blihen? Çka të merret parasysh?

Zogjtë duhet të blihen nga strehimoret lokale të kafshëve, të cilat drejtohen nga një shoqatë për mbrojtjen e kafshëve ose në një dyqan të specializuar të kopshtit zoologjik, i cili i mban kafshët e veta në mënyrë të përshtatshme sipas llojit dhe këshillon në mënyrë kompetente, kështu për shembull në një dyqan me etiketën e kualitetit VZFS Codex, ose nga një kultivues i kafshëve/kafshërritës, të cilit duhet ti vështrohen paraprakisht, në mënyrë kritike, mënyra e rritjes së kafshëve dhe kushtet e rritjes. Është me rëndësi të merret parasysh që të mos blihen zogj me tipare ekstreme. Ekzistojnë kanarinë me kaçule, të cilët për shkak të kaçirubës nuk shohin më asgjë ose kanarinat e pozës si "Gibber Italicus", e cila u kultivua deri në gjymtim. Këto forma duhet të mënjanohen dhe të zgjidhen zogj me pupla dhe formë trupore normal.
Mënjanoni tërësisht blerjen e kafshëve përmes internetit! Ofertat e kafshëve përmes internetit shpesh kanë origjinën e prodhimit masiv dhe ato kultivohen në kushte të tmerrshme të mbajtjes. Gjithashtu edhe tregtia ilegale me kafshë bëhet përmes shpalljeve falas në internet, dhe mashtrimet janë po ashtu prezentë.

Çka ju nevojitet zogjve?

Kafazet duhet të qëndrojnë në vend të ndritshëm, së paku të rrezatuar me diell gjatë një pjese të ditës (p. sh. dhomë nga juglindja), por në rast nevoje duhet të jetë e mundur që ato hijesohen. Më së miri është që ky vend të mos jetë i arritshëm nga të gjitha anët, kështu që zogjtë të kenë njëfarë mbulese. Zogjtë duhet të kenë mundësi që edhe të tërhiqen gjithmonë në lartësi, më lartë se lartësia e syve e vështruesit – hija e një njeriu nga lartë bën përshtypjen e një armiku ajror (shpend grabitqar) dhe kjo shkakton stres. Rryma e ajrit (rrymimi/shuaja), pengesat e panevojshme (kafshët tjera, fëmijët) dhe një ndriçim i parregullt duhet të mënjanohen. Në të njëjtën dhomë nuk duhet as të pihet duhani, as të zihet dhe as të shikohet televizioni. Agaponidët si gjumbërës shpellash dhe trishtili zebër si gjumbërës foleje kanë nevojë për mundësi të përshtatshme për fjetje si shporta të thurura. Vendosja e çerdheve dhe foleve tek llojet e tjera të zogjve shkakton në të vërtetë ëndjen për pjellje (për tu riprodhuar).
Nevojiten një banjë për shpendë, enë për ushqim dhe pirje, të mbushura gjithmonë me ujë të freskët. Kafazet pajisen me degë nga natyra si shtagë ulëse (të ndërrohen gjithashtu në kafaze shtaga prej plastike dhe shtanga nga druri i ngjitur!) dhe, çdo disa ditë të vendosen degëza të freskëta si material pune. Jo helmuese janë: bredhi i kuq, bredhi i bardh, lajthia, shelgu, ahu, mështekna, bliri, pemët frutore të pa stërpikura. Rëra për shpendë duhet po ashtu për të pasur gjithherë, ose në patos si mbulesë e shtruar ose në një filxhan. Zogjtë kanë nevojë për gëlqere si shtesë, në formën e filxhani të errët ose nga gurë të veçantë gëlqeror. Në dyqanet e kopshtit zoologjik shitet ushqimi special për çdo lloj, mirëpo kafshëve duhet t´ju ofrohet edhe laramani dhe ballafaqim (p.sh. ushqim i përgatitur me kostrevë, kallinj drithi, farëra të egra, filiza...).

Kontrollimi i riprodhimit (shumimit)

Duhet hequr dorë nga shumimi i zogjve, ngaqë vendosja e zogjve të ri në vendet vërtet të volitshme për jetën e kafshëve është jashtëzakonisht e vështirë ose e pamundur, përveç kësaj presin një numër i mjaftueshëm i këtyre kafshëve jetëgjata, për një vend të mirë nëpër strehimoret për kujdesjen e

kafshëve dhe në stacionet mbledhëse. Që të mënjanohet shumimi te shumica e zogjve mjafton që të mos ju ofrohet rasti i përshtatshëm për të zënë folenë (shpellë e çerdhes te papagalli të valësuar, koritë çerdhe te zogjtë kanarinë). Megjithatë nëse fillon femra të ndërtoj një fole, ekziston mundësia e zëvendësimit të vezëve mbas bërjes së tyre, me vezë artificiale. Rritja në dorë është për tu refuzuar, sepse në këtë mënyrë krijohen kafshë të karakterizuara me gabime , me të meta në të sjellur si dhe me sëmundje, gjithashtu duhet hequr dorë nga blerja e zogjve të rritur në dorë!

Zogjtë dhe pushimet

Zogjtë të ndjeshëm ndaj stresit rrinë më së miri në kafazet e tyre te shtëpia, ushqehen dhe mirëmbahen prej një personi të specializuar dhe të besueshëm. Ata mund të strehohen si alternativë në një pansion për kafshë ose në një shtëpi për kujdesjen e kafshëve të braktisur, gjë që kushton 15-30 franga në ditë. Lëshimi i kafshëve në rrugë është i ndaluar me ligj dhe mund të ndëshkohet me një gjobë deri në 20 000 franga.

Zogjtë dhe fëmijët

Zogjtë e mbajtur sipas llojit përkatës ofrojnë mundësi tepër tërheqëse vrojtimi për fëmijë. Zbutja e zogjve të ndjeshëm ndaj stresit si „kafshë ledhatuese“ është megjithatë e dyshimtë. Fëmijët vet nuk munden ta marrin përsipër për përkujdesjen ndaj zogjve. Një i rritur duhet ta merr përgjegjësinë, ti udhëzon dhe të mbikëqyr fëmijët në sjelljen e tyre me kafshë.

Informacionet dhe vendet për kontakt

- Broshurë: „Vögel als Heimtiere“ (zogjtë si kafshë shtëpiake) (gjermanisht, frëngjisht, italisht), këshillues, mund të porositen falas, duke dërguar një zarf C5 të pajisur me pullë dhe të adresuar vetvetes tek Mbrojtja Zvicerane e Kafshëve STS, Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, Postfach, 4008 Basel, Tel. 061 365 99 99, Faksi: 061 365 99 90, materialit www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com, këshillim falas (gjermanisht, frëngjisht, anglisht), broshura falas, adresa të strehimoreve të kafshëve, klubi i fëmijëve www.krax.ch.
- Stacioni për mbledhjen e papagajve APS, seksioni i Mbrojtjes Zvicerane të Kafshëve STS, Frauenfelderstrasse 95, 9548 Matzingen, Tel. 052 376 45 45, www.auffangstation.ch, info@auffangstation.ch, strehimore për papagaj, këshillim falas, vendosja e papagajve të pastrehë/pa vendlindje.
- Broshura “Wellensittiche – Tiere richtig halten” (Papagalli i valëzuar – Mbajtja e duhur e kafshëve“ (gjermanisht, frëngjisht, italisht), e botuar nga Enti i Veterinës BVET. Mund të porositet falas ose të shkarkohet në formatin PDF nga BVET: www.bvet.admin.ch dhe www.tiererichtighalten.ch
- Libër shumë i rekomandueshëm mbi papagajtë e valëzuar:“Wellensittiche verstehen und artgerecht halten” (Të kuptuarit e papagajve të valëzuar dhe mbajtja adekuate sipas llojit të tyre)(vetëm në gjermanisht), Esther Wullschleger Schättin, CHF 36.–, porosia përmes: www.nature-themes.ch
- Volierenbau Senn, R. Senn, Wiesenweg 2, 3373 Heimenhausen, Tel./faksi 062 961 65 68, mobili: 079 332 95 68, www.volieren.ch, info@volieren.ch

Redaktor:

Schweizer Tierschutz STS, Dornacherstrasse 101, 4008 Basel,
Tel. 061 365 99 99, Fax 061 365 99 90, www.tierschutz.com, sts@tierschutz.com